



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: **583/25** Datë: **27.05.2025**

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 137 të mbajtur më 19.05.2025, mori:

V E N D I M

- I.** Akreditohet programi i studimit i Kolegjit Rezonanca për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2025 – 30 shtator 2028):
 - *Menaxhim i Kujdesit Shëndetësor dhe Ekonomi Shëndetësore, MSc 120 ECTS*; me kuotë 50 studente për vit akademik.
- II.** Numri i studentëve vlen dhe zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III.** Obligohet Kolegji Rezonanca që deri më datë 30.09.2025 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV.** Obligohet Kolegji Rezonanca të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.
- V.** Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VI.** Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Kolegji Rezonanca brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Menaxhim i Kujdesit Shëndetësor dhe Ekonomi Shëndetësore, MSc 120 ECTS;</i>	Isak Berbatovci Albiona Rashiti Bytyqi

Me qëllim të vlerësimit të programit të studimit, AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin Rezonanca.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelori dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtarë) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

Për programin e studimit; Menaxhim i Kujdesit Shëndetësor dhe Ekonomi Shëndetësore, MSc 120 ECTS; vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 19.03.2025 me këtë përbërje: Angelo Miguel Cardoso Jesus, Joke Denekens dhe Giorgi Gvenetadze. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtarë ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht pesë (5) fusha të standardeve të akreditimit,
- Substancialisht një (1) fushë të standardeve të akreditimit dhe
- Pjesërisht një (1) fushë të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 137-të, të mbajtur më datë 19.05.2025, ka shqyrtuar dokumentacionin e Kolegjit Rezonanca dhe duke u bazuar në raportin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji Rezonanca;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë